



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE PËRMIRËSIMIT TË KLIMËS SË BIZNESIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2021

Lënda: Kthim përgjigje për informacion mbi pakicat kombëtare.

MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
Bulevardi Gjergj Fishta, Tiranë.

I nderuar Z. Armand Skapi,

Në përgjigje të kërkesës Suaj, datë 26.02.2021 nr. prot. 2587, për informacion lidhur me pakicat kombëtare në nivel vendor, Ju dergojmë informacionin si më poshtë vijon:

Komuniteti rom është i vendosur në territorin e bashkisë Shkodër 20 vitet e fundit dhe është vazhdimisht në lëvizje të brendshme migratore. Rreth 90% e këtij komuniteti nuk kanë regjistrimin civil në Bashkinë Shkodër. Në territorin e Bashkisë Shkodër, aktualisht janë të identifikuar 5 vendqëndrime informale, ku jetojnë rreth 450 persona të komunitetit rom.

Qendra Komunitare Multifunkionale “Për familjen”, si pjesë e rrjetit të shërbimit komunitar të bashkisë, është ngritur dhe funksionon në zonën ku ka përqëndrim të komunitetit Rom dhe ofron shërbime të përkujdesjes sociale për komunitetin rom. Qendra mundëson aksesin në një gamë të gjërë të shërbimeve sociale të integruara me bazë në komunitet si: këshillim psikologjik, ndihmë mjekësore, klasa passhkollore, ndërmjetësim punësimi etj.

Në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptjanëve në Republikën e Shqipërisë 2016 – 2020”, Bashkia Shkodër ka miratuar dhe zbatuar “Planin e zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian” 2017 -2020”, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 80 datë 21.12.2017 “Për miratimin e Planit të zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian”.

Masat e ndërmarra për realizimin e ndërhyrjeve të parashikuara dhe realizimin e aktiviteteve dhe arritjen e objektivave të Planit të zhvillimit lokal për komunitetn rom dhe egjiptian në Bashkinë Shkodër sipas fushave prioritare të parashikuara, rezulton si më poshtë:

Regjistrimi civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë

Për shkak të jetesës kryesisht endacake dhe lëvizjeve, komuniteti Rom ka problem, së pari me regjistrimin e vendbanimeve, por edhe më tej me regjistrimin në gjendjen civile, që vështirëson aksesin e pjesëtarëve të komunitetit në shërbimet publike dhe programet e ndryshme që synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës për grupet vulnerabël të shoqërisë. Regjistrimi civil i pjesëtarëve të komunitetit rom është problem kompleks dhe varet edhe nga problematika të tjera që shoqërojnë këtë komunitet siç janë martesat në moshë të hershme, bashkëjetesa të shumta, martesat të pazgjidhura nga ana ligjore, familje të mëdha, mungesë dokumentacioni, mungesë e vullnetit etj.

Qendra Komunitare Multifunkionale “Për familjen” (QKMF) në bashkëpunim të ngushtë me organizatat partnere kanë realizuar fushata sensibilizuese rreth regjistrimit civil dhe transferimin e vendbanimeve. Si rezultat i zbatimit të një procedurë të posaçme për transferimin e banimit të komunitetit rom, që banojnë në Baraka, e cila shmang barrierat administrative, është realizuar tranferimi i vendbanimit rreth 18 familje të asistuar nga stafi i QKMF. Vlen të theksohet që procedura është kthyer në një praktikë suksesi. Tashmë këto familje mund të kenë akses në shërbimet publike të ofruara në territor.

Stafi i Qendrës Komunitare Multifunkionale “Për familjen” ka mbështetur procesin e rregjistrimit civil të fëmijëve, të cilëve iu ka munguar ky dokumentacion ligjor.

Zgjidhja e problematikave që kanë lidhje me regjistrimin civil dhe ndryshimin e vendbanimit të komunitetit rom është një hap i rëndësishëm në rritjen e aksesit në shërbimet bazë publike dhe në përfshirjen e tyre sociale.

Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor

Fokusi i punës së strukturave përgjegjëse të shërbimeve sociale në Bashkinë Shkodër është venë te edukimi i komunitetit rom duke qënë se përfaqëson mundësinë më të madhe për ndryshim dhe integrim. Numri i shkollave dhe kopshteve që frekuentohet nga fëmijët rom është rritur nga 9 në 12 gjatë periudhës kohore 2016-2020. Kjo tregon që fëmijët romë kanë nisur të integrohen në institucionet arsimore të bashkisë. Këto tregues reflektojnë përpjekjen për të evituar diskriminimin për shkak të racës dhe mbështetjes për integrimin e komunitetit rom.

Numri i fëmijëve që marrin klasa passhkollore pranë QKMF është 60 dhe fëmijë që përfitojnë klasa përgatitore janë 30. Klasat passhkollore që ofrohen pranë Qendrës Komunitare Multifunkionale për Familjen kanë si qëllim të mbështesin fëmijët që kanë vështirësi në nxënie gjatë procesit mësimor, në mënyrë që të integrohen sa me lehtë me bashkëmoshatarët e tyre në shkollë, ndërsa klasat parapërgatitore përgatisin fëmijët e moshës parashkollore për fillimin e klasës së parë, kryesisht për ata fëmijë që nuk kanë frekuentuar kopshtet.

Një tjetër arritje në fushën e arsimit që lidhet drejtpërsëdrejti ka të bëjë me lehtësimin e integritit të fëmijëve të komuniteteve rom dhe egjiptian në sistemin parashkollor. Bashkia ka miratuar në paketën fiskale përjashtim nga tarifa e koshteve dhe çerdheve për disa kategori ku përfshihen edhe romët dhe egjiptjanët. Gjithashtu pranë QKMF ofrohen vakte ushqimore për rreth 55 fëmijë si dhe transport falas për rreth 135 fëmijë për të lehtësuar frekuentimin çdo ditë të kopshtit dhe shkollës. Janë mbështetur me mjete didaktike, çanta dhe uniforma rreth 135 fëmijë romë dhe egjiptjanë për këtë vit shkollor.

Promovimi i diversitetit dhe dialogut kulturor realizohet përmes një sërë aktiviteteve ndërgjegjësuese që realizohen nga Bashkia Shkodër në bashkëpunim me organizata dhe institucione të tjera. Të gjitha këto me qëllim për të celebruar historinë, traditat dhe kulturën rome dhe egjiptiane si dhe për të promovuar diversitetin kulturor ashtu si edhe thirrje për përfshirje sociale.

Kujdesi shëndetësor

Komuniteti rom përgjithësisht është i mbuluar më shërbime shëndetësore, pasi infrastruktura fizike e godinave që ofrojnë kujdes shëndetësor për këtë komunitet është përmirësuar.

Janë ndërmarrë fushata sensibilizuese rreth vaksinimit dhe si rezultat, janë vaksinuar 219 fëmijë rom, dhe 32 të rritur si dhe 119 pjesëtarë të komunitetit rom janë pajisur me karta shëndeti.

Për të lehtësuar familjet që kanë probleme të mëdha shëndetësore me familjarët e tyre, janë ndihmuar me blerjen e medikamenteve dhe vizita mjekësore, janë mbuluar me shpenzime për dy ndërhyrje kirurgjikale, si dhe janë mbështetur për rimbursimin e barnave për familjet shumë të varfra.

Drejtoria e shërbimeve sociale në bashkëpunim me Qendrën Multifunkionale organizojnë sesione edukimi dhe këshillimi. Në këto vite janë ndërmarrë katër fushata sensibilizuese rreth vaksinimit. Për arsye të rezistencës për të bërë vaksinimin nga ana e komunitetit rom, është realizuar vaksinimi në komunitet.

Punësimi, arsimit dhe formimi profesional

Komuniteti Rom në Shqipëri karakterizohet nga nivele të larta papunësie, ku dominon papunësia afatgjatë.

Ndër arsyt kryesore që lidhen me këtë gjendje, në vite, janë evidentuar të jenë mungesa e mundësive për punësim në vendin tonë, niveli i ulët arsimor dhe diskriminimi me bazë përkatësinë etnike. Një nga format e punësimit të komunitetit rom është grumbullimi dhe riciklimi i mbetjeve. Një tjetër karakteristikë e komunitetit rom janë dhe punimet e artizanatit, kryesisht të kashtës dhe gjatë sezonit veror shumë prej tyre angazhohen nga subjekte të ndryshme në plazhin e Velipojës për përgatitjen e çadrave karakteristike të kashtës.

Raportohet një numër i ulët i anëtarëve të komuniteteve rome dhe egjiptiane që marrin pjesë në kurset e formimit profesional. Aksesit i ulët i kurseve nga ky komunitet është rezultat jo vetëm i interesit të ulët që shfaqin vetë pjesëtarët e dy komuniteteve por edhe për shkak të kriterëve ligjorë të përcaktuara (arsimi i detyrueshem si kriter ligjor). Por nga ana tjetër ka shumë inisiativa të organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë kurse të formimit profesional falas për përfaqësues të dy komuniteteve.

Qendra Komunitare Multifunktionale “Për familjen” në bashkëpunim me organizatat të shoqërisë civile që veprojnë aty, kanë ndërmarrë disa inisiativa për nxitjen e punësimit të këtyre komuniteteve ku mund të përmendim edhe shembuj pozitiv të integritit.

Megjithatë punësimi i komuniteteve veçanërisht i komunitetit rom mbetet një nga sfidat kryesore për integrimin e tyre.

Strehimi dhe integrimi urban

Komuniteti rom për shkak të shumë sfidave: problematika që kanë me regjistrimin në gjendjen civile dhe ose banesat; pamundësinë për të dokumentuar të ardhurat e tyre; aftësisë së ulët paguese kanë mundësi më të ulëta për të përfituar nga programet e strehimit social.

Për këtë arsye bashkia po zbaton projektin “Ndërtim i godinave sociale me kontener 1+1 dhe 2+1”, falë të cilit do të ndërtohen 28 banesa sociale ku do të përfitojnë 28 familje rome. Falë këtij projekti shumë shpejt familjet rome do të kenë mundësi të kenë strehim të përshtatshëm.

Mbrojtja sociale

Duke marrë në konsideratë faktin se komuniteti rom është ndër komunitetet me shkallën më të lartë të varfërisë, ata përfaqësojnë edhe grupet prioritare të programeve të mbrojtjes sociale.

Numri i familjeve rome që përfitojnë ndihmë ekonomike është ulur si pasojë e zbatimit të ligjit të ri për ndihmën ekonomike. Nga informacioni që disponon QKMF rezulton që edhe numri i familjeve rome që përfitojnë ndihmë ekonomike në bashkitë e origjinës është ulur ndjeshëm. Kufizimet e ligjit të ri përjashtojnë nga skema e ndihmës ekonomike edhe familje që janë realisht të varfëra.

Konkretisht menaxhohen rreth 89 raste të familjeve rome dhe egjiptjane nga Qendra Komunitare “Multifunkionale “Për Familjen”, të cilat mbështeten sipas planeve individuale të ndërhyrjes dhe QKF nr 5 ka të përfshirë në procesin e fuqizimit ekonomik.

Gjatë periudhës së COVID-19 bashkia Shkodër ka vijuar punën për të mbështetur komunitetet në nevojë. Qendra Komunitare Multifunkionale ka ofruar shërbim për fëmijët dhe familjet rome dhe egjiptiane duke respektuar rregullat për parandalimin e COVID -19. Ka vijuar puna dhe me mbështetjen direkte të familjeve rome me pako ushimore, pako higjienike dhe maska mbrojtëse, gjithashtu gjatë kësaj periudhe është ndërhyrë në dezinfektimin e ambjenteve të jashtme pranë vendqëndrimit të komuniteti rom si dhe në ambientet e brendshme, në barakat ku jeton ky komunitet.

KRYETAR

Voltana Ademi